

Bashkia: ELBASAN

Kryetar: QAZIM SEJDINI

Fusha: INFRASTRUKTURË DHE SHËRBIME PUBLIKE

Premtime:

1. Do të nxitet krijimi i Fondit Kombëtar të Furnizimit me Ujë, me kontribute konkrete nga buxheti lokal dhe nga donatorët ndërkombëtarë, në mënyrë që të arrihet në zgjidhje të qëndrueshme brenda mandatit katërvjeçar në rreth 70% të fshatrave
2. Do të forcohet kontrolli dhe asistenca e drejtpërdrejt për monitorimin e puseve informale të ujit të pijshëm, apo atyre që përdoren për aktivitet ekonomik bujqësor
3. Do të zgjerohet shërbimi i transportit publik në zonat e nevojshme pa mbulim, duke shtuar ngrehinat e stacioneve të autobusëve dhe duke përmirësuar rrënjësisht kushtet e transportit
4. Korridorin 8-të do të përfshijë bypass-in në pjesën jugore të qytetit, do të shërbejë edhe si zonë buferike në perëndim të qytetit, duke bërë të mundur ndalimin e shtrirjes urbane në drejtim të Kombinatit Metalurgjik, ndërkohë që mbjellja e drurëve përgjatë tij do të ndikojë në përmirësimin e cilësisë së ajrit
5. Do të kryhet Unaza Rajonale që përfshin një unazë të plotë, e cila mbyllet me Urën e Shkumbinit; do të fillojë nga Papri dhe duke ecur paralelisht me Shkumbinin, do të mbyllet në zonën ekonomiko bujqësore të Paprit
6. Do të zhvillohen gradualisht akset kryesore: Unaza e Madhe e Elbasanit, lidhja e drejtpërdrejt e Elbasanit me Shushicën me anë të një ure të re, si edhe fuqizimi i akseve që lidhin qendrat kodrinore/malore me Unazën rajonale, duke plotësuar, aty ku mungojnë, lidhjet e qendrave me njëra-tjetrën
7. Do të përfundojë studimi dhe projektet për nyjet lidhëse të Unazës rajonale me rrugën Elbasan- Tiranë, Elbasan- Durrës dhe Elbasan-Pogradec (Librazhd)
8. Do të nxitet ndërtimi i një stacioni të ri hekurudhor në afërsi të kombinatit, ndërkohë që stacioni ekzistues mund të kthehet në një zonë eventesh apo panairesh gjithëvjetore
9. Do të rikonstruktohen qendrat e ish-komunave (3,4 milion euro për rehabilitimin e qendrave të ish- komunave)
10. Do të arrihet që në çdo ish-komunë të sigurohet transport publik çdo 30-45 minuta
11. Përgjatë Unazës rajonale do të parashikohen terminale apo vendparkime për automjetet e linjave publike
12. Bashkia do të zgjidhë përfundimisht shtimin e korsive të biçikletave për të nxitur lëvizjen me to në territorin e bashkisë
13. Do të sigurohet ujë 24 orë në qytet brenda vitit; uji për vaditje dhe azhurnimi i tokave të gjithë territorit të Bashkisë së re Elbasan, do të zgjidhet brenda dy viteve. Ndërsa në të gjitha fshatrat, ky do të jetë një problem që do të marrë zgjidhje brenda mandatit 4-vjeçar (22 milion euro për 24 orë ujë në qytet dhe fshat, 7 milion për qytetin brenda 1 viti, pjesa tjetër për fshatin brenda mandatit)

14. Fshatrat do të kenë ndriçim rrugor
15. Do të ndërtohet sistemi i kanalizimeve të ujërave të zeza (30 milion euro për ndërtimin e impiantit të kanalit të ujërave të zeza)
16. Do të vendosen 28 mijë sahatë digjitale të ujit të pijshëm për çdo abonent, kosto e Bashkisë, për qytetarët do të jetë falas
17. Do të rikonstruktohen pusët (5 milion euro) me pompa digjitale
18. Do të kryhet rehabilitim i infrastrukturës rrugore (30 milion euro)
19. Do të hartohet plani i zhvillimit të Elbasanit
20. Do të kryen 6 qendra të qytetit në lagje të ndryshme (deri në 2019)

Fusha: ARSIM/KULTURË/SPORT

Pretime:

1. Do të kryhet transporti i fëmijëve në shkolla me mjete publike në territorin e bashkisë, falas për shtresat në nevojë dhe vendosja e sistemit të aboneve nga Bashkia Elbasan
2. Në qytet do të ndërtohen 4 kopshte të reja brenda mandatit 4-vjeçar dhe 12 kopshte të reja do të ndërtohen në çdo qendër të 12 ish-komunave që tani janë pjesë e Bashkisë Elbasan
3. Do të kryhet mbështetje për të rinjtë për të investuar në nisma e ide individuale të zhvillimit të karrierës së biznesit
4. Do të kryhet hapja e zyrës së karrierës për të rinjtë, përmes partneritetit publik-privat
5. Do të kryhet ngritja e një qendre multifunksionale të arsimit profesional, bazuar në infrastrukturën ekzistuese dhe e plotësuar me konvikt për nxënësit dhe kursantët që nuk janë nga qyteti
6. Do të kryhet ngritja e një shkolle profesionale bujqësore në territorin e bashkisë
7. Do të kryhet dhënie e bursave dhe ndërmjetësimi përmes zyrës së karrierës për studime universitare
8. Do të kryhet hapja e bibliotekave publike për çdo njësi administrative në qytet dhe në çdo qendër ish-komune
9. Do të kryhet ndërtimi i kompleksit artistiko-kulturor shumë aktivitetësh nëpërmjet partneritetit publik-privat në territorin e bashkisë
10. Do të kryhet kthimi i ambienteve sportive në shkolla në qendra e kënde sportive për fëmijët dhe të rinjtë
11. Do të zhvillohet komunikimi digjital, duke siguruar internet në çdo qendër ish-komune (projekt USAID)
12. Do të kryhet sistemi i ngrohjes së shkollave 9 vjeçare dhe të mesme (3,5 milion euro) në territorin e bashkisë
13. Do të kryhet rehabilitimi i të gjitha shkollave (5 milion euro) në territorin e bashkisë
14. Të gjitha kopshtet do të kenë ngrohje me panale diellore, nuk do të ketë më asnjë problem me ngrohjen në kopshtet publike në qytet
15. Brenda 1 viti do të ndërtohet palestra e Kopshtit Nr. 9

Fusha: MJEDIS/TURIZËM

Pretime:

1. Do të zhvillohet turizmi nëpërmjet hedhjes së të dhënave në internet dhe me publicitet në mediat lokale e kombëtare që kushdo që do të vizitojë kalanë e Elbasanit, të interesohet edhe për kishën e Shelcanit, Fushën e Kuqe të Gjinarit, Gurrën e Labinotit Mal, Rrepet e Byshekut, etj
2. Do të studiohen infrastrukturat e nevojshme dhe veçanërisht rrugët lidhëse për të rritur aksesin dhe për t'i bërë zonat malore lehtësisht të vizitueshme nga gjithkush
3. Do të kryhet rehabilitimi i fushës ekzistuese të depozitimit të mbetjeve pas ndërtimit të inceneratorit në zonën e Kombinatit Metalurgjik (6 milion euro për mbylljen e fushës ekzistuese të grumbullimit të mbetjeve)
4. Do të hiqet dorë përfundimisht nga ndotja e lumenjve dhe luginave me qese plastmase e mbetje të të gjitha llojeve
5. Zona industriale e bashkisë së madhe do të monitorohet me rreptësi për të shmangur ndotjen e mëtejshme të mjedisit dhe sidomos të ajrit
6. Do të pastrohet Diga e Zaranikës, si dhe do të hartohet një projekt për lumin Shkumbin
7. Do të rehabilitohet dhe do të zhvillohet më tej me programe të ndryshme pyllëzimi, të diskutuara e dakordësuara gjerësisht me komunitetet përkatëse
8. Zona jugore e Unazës së Madhe do të pyllëzohet me ullinj, njësoj si pjesa veriore e qytetit të Elbasanit
9. Do të hartohet plan menaxhimi për zonat e mbrojtura, në mënyrë që të ndalohet dëmtimi i tyre dhe të krijohen kushte për përfitime ekonomike nga komunitetet që banojnë pranë tyre
10. Në vitin 2016 do të përfundojë landfilli i Elbasanit, në zonën e ish-kombinatit Metalurgjik, investim i cili ka nisur dhe po vijohet me intensitet

Fusha: BUJQËSI

Preftime:

1. Bashkia do të ketë inspektoriatin bujqësor për çdo shërbim në bujqësi, shërbimet do të jenë të gjitha falas; Çdo njësi administrative do të ketë ndërmarrje shërbimi jo vetëm për rrugët por edhe për kanalet e vaditjes
2. Azhurnimi i tokave në të gjithë bashkinë e re do të bëhet në drejtorinë përkatëse në këtë institucion qendror të qeverisjes lokale
3. Do të kryhet rehabilitimi i kanaleve vaditëse dhe kulluese (15 milion euro)

Fusha: TRANSPARENCA

Preftime:

Fusha: SHËRBIMET SOCIALE

Preftime:

1. Do të vazhdojë funksionimi i qendrave sociale dhe do të dërgohet ushqim në shtëpi atyre që nuk vijnë dot në qendër

Fusha: EKONOMI DHE PUNËSIM

Premtime:

1. Brenda 4 viteve do të punësohen 10 mijë persona: *Në Fushën e kombinatit metalurgjik do të investohet nga biznesi privat dhe do të kërkojë punëtorë; Do të përthithen projekte për grantet e punësimit nga qeveria do të thithen më shumë investime; 2 impiante ferokrom dhe rafineri naftë që kërkojnë 700 punëtor për tu ndërtuar; Ndërmarrjet bujqësore nga impianti i djegjes së mbetjeve kërkojnë mbi 500 punëtorë; 3 punishte peshku që kërkojnë 600 punëtorë; 1 ndërmarrje fason që kërkon 300 gra*
2. Programet bashkiake të nxitjes së punësimit që do të mundësojnë nxitjen dhe hapjen e vendeve të punës që është nxitje për zhvillimin e ekonomive të vogla lokale
3. Taksat nuk do të ulen, do të ngelen në nivelin që janë